

27 tetor 2025,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 27.10.2025, Prishtinë

Interpretimi i Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore lidhur me Ligën
Zhvillimore U21 Vajzat

Pas shqyrtimit të kërkesës së klubit KBF Reggio Basket Academy (RBA U21) për regjistrimin e lojtareve të huaja në Ligën Zhvillimore U21 Vajzat, dhe pasi u mor parasysh qëndrimi i Komisionit të Garave të FBK-së lidhur me këtë çështje, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në ushtrimin e kompetencave të tij për interpretim të dispozitave të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, nxjerr këtë:

INTERPRETIM

1. Bordi i FBK-së pajtohet plotësisht me interpretimin e Komisionit të Garave, të dhënë në Vendimin Nr. 06/2025-26, lidhur me karakterin dhe qëllimin e Ligës Zhvillimore U21 (Vajzat)..
2. Qëllimi themelor i Ligës U21 është zhvillimor, duke u fokusuar në rritjen dhe avancimin e lojtareve të reja vendore (kosovare), në përputhje me objektivat strategjike të FBK-së për zhvillimin e basketbollit të femrave në vend.
3. Ky qëllim është i përcaktuar qartë edhe në thirrjen publike të FBK-së për aplikim në ligë, ku ndër të tjera theksohet:

“Kjo ligë ka karakter zhvillimor dhe synon fuqizimin e talentëve të reja të basketbollit të femrave në Kosovë, duke ofruar hapësirë për lojtaret U21 dhe mundësi për përfshirje të kontrolluar të lojtareve me përvojë.”

4. Në këtë kontekst, interpretimi i Bordit është se dispozitat që lejojnë përfshirjen e dy lojtareve mbi moshën 21 vjeç nuk mund të kuptohen si leje për përfshirjen e lojtareve të huaja, por si mundësi për përfshirjen e lojtareve vendore me përvojë, në funksion të qëllimeve zhvillimore të garës.
5. Prandaj, në përputhje me misionin dhe frymën e Ligës U21, përfshirja e lojtareve të huaja në këtë ligë nuk është në përputhje me qëllimin e saj zhvillimor dhe bie ndesh me arsyetimin për të cilin kjo ligë është themeluar.

Rrjedhimisht, Bordi i FBK-së, përmes këtij interpretimi konfirmon qëllimin zhvillimor të Ligës U21 dhe mbështet interpretimin e Komisionit të Garave në rastin konkret, pa ndërhyrë në vendimmarrjen e tij procedurale.

Ky interpretim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i FBK-së dhe do të zbatohet si praktikë e detyrueshme për të gjitha rastet e ngjashme në vijim.

Arben FETAHU

Federata e Basketbollit të Kosovës

